



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:004335

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06504059

**2020:004336**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.A., A.I. dhe B.T., për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/ nr.2292-3/19, të datës 18.02.2020, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor publik, më datë 20.11.2024, në prani të prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu dhe të akuzuarve H.A. dhe B.T., me datë 21.11.2024, mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datë 25.11.2024, përpiloi me shkrim këtë:

### **AKTGJYKIM**

I akuzuari H. A., nga i ati B., e ëma F., e gjinisë H., i lindur me dt..... në Prishtinë, me vendbanim në fsh.... K Ferizaj, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion hotelier, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë për ndonjë vepër penale dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

I akuzuari B.T., nga i ati N., e ëma F., e gjinisë K., i lindur me dt....., në Prishtinë, me vendbanim në fsh.... K Ferizaj, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i një fëmije, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale.

**JANË FAJTOR**

Sepse më datën 29.12.2019, rreth orës 19:40, në kafiterin “.....” në Ferizaj, pas një mosmarrëveshje verbale të pandehurit me dashje që t’i shkaktojnë lëndime trupore në bashkërisht e kanë sulmuar me grushte në kokë të dëmtuarin K. B., me ç’rast i njëjti nga goditjet pëson lëndime të lehta trupore, për çka dhe posedon raport mjekësor.

Më këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 185 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe në bazë të neneve 364, 452,462, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarit i:

## **GJYKON**

### **Të akuzuarin e parë**

Me dënim me të holla në shumë prej 200 € /dyqind euro/,

### **Të akuzuarin e dytë**

Me dënim me të holla në shumë prej 200 € /dyqind euro/,

Dënimet e shqiptuara në të holla të akuzuarit janë të obliguar ti paguaj në afat prej 30 /tridhjetë/ ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se të akuzuarit nuk i paguajnë dënimet me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPRK-së, të njëjtëve dënimet do t’iu shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’iu llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumë prej nga 20 € (njëzet euro), për shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjeko ligjore) në mënyrë solidare shumë prej 20 €, /njëzet/ Euro, si dhe konform nenit 36 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit poashtu shumë prej nga 20 /njëzet/ Euro, që të gjitha shumat obligohen ti paguajnë mbrenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari K. E. B. nga Ferizaj rruga “.....” ndërtesa Ideal, për realizimin e kërkesës pasurore –juridike, udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m i**

### **Historiku i Procedurës**

Prokuroria Themelore Ferizaj-Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën e saj PP/ nr.2292-3/19,e datës 18.02.2020, ka ngarkuar të akuzuarit për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe t’u shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën janë proceduar të akuzuarit gjykohen nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 20.11.2024, në të cilin shqyrtim gjyqësor ishin të pranishëm Prokurori i shtetit dhe të akuzuarit H.A. dhe B.T., ndërsa i pandehuri A.I. ka munguar dhe në bazë të Memorandumit Zyrtar të Stacionit policor në Ferizaj nr 04/01-05F-963/23 i dt.13.10.2023, është konstatuar se i njëjti gjendet jashtë shtetit. Andaj gjyqtari merr mendimin e palëve për veçimin e procedurës për të akuzuarin A.I., të cilët në deklarimin e tyre u pajtuan që procedura ndaj të akuzuarit në fjalë të veçohet.

Gjykata pasi ka marrur mendimin e palëve, me Aktvendim të dt.20.11.2024, ka veçuar procedurën penale për të akuzuarin A.I. nga fsh..... Komuna Ferizaj, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së ,dhe ka vendosur që për te të formohet lëndë e re penale dhe që e njëjta lëndë të merr numër të ri në regjistrat e gjykatës në divizionin penal, kurse me të akuzuarit H.A. dhe B.T., ka vazhduar shqyrtimin gjyqësor, për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për të cilën janë akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë.

**Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka udhëzuar të akuzuarit për të drejtat e tyre në kuptim të nenin 319 par.1 dhe 2 të KPPRK-së dhe pasi që të akuzuarit kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjyqtari është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 321 paragrafi 1 të KPPRK-së, i ka afuar mundësinë që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pa fajësinë për veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Përkitazi me këtë i akuzuari i parë deklaroi, e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit për të gjitha pikat e saja.

Po ashtu dhe i akuzuari i dytë deklaroi, e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza e prokurorit të shtetit për të gjitha pikat e saja.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 322 paragrafi 2 të KPPRK-së, ka kërkuar mendimin e prokurorit të shtetit dhe të palës së dëmtuar.

Prokurori i shtetit deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë pasi të njëjti e kanë bërë pranimin e fajësisë konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPPRK-së.

Pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 242 par.2 të KPPRK-së, ngase të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit dhe pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, aktakuza nuk ka përmbajtur asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në faktet provat materiale të rastit konkret dhe atë ne provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit siç janë: deklarata e të pandehurit H.A. e dhënë polici me dt. 29.11.2019, deklarata e të pandehurit A.I. e dhënë polici me dt. 29.11.2019 deklarata e të pandehurit B.T. e dhënë polici me dt. 29.11.2019, deklarata e të dëmtuarit K. B. e dhënë në Stacionin policor në Ferizaj me dt. 29.11.2024, Raporti i Qendrës Emergjente në Ferizaj-Spitali i Përgjithshëm për të dëmtuarin K. B. nr. 327 i dt. 29.11.2024, aktekspertimi mjeko-ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes nga dr.Dritor Haliti i dt.08.02.2020 dhe shkresat tjera të lëndës.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin gjyqësor pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

### **Fjala përfundimtare e palëve**

Pasi që Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, konform nenit 322 paragrafi 4 të KPPRK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se meqenëse e të akuzuarit pranuan fajësinë atëherë gjendja faktike është vërtetuar ashtu siç përshkruhet në aktin akuzues e kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi i fajësisë nga të akuzuarit u bë vullnetarisht, pa presion dhe të vetëdijshëm për pasojat e pranimit, andaj kërkojmë nga gjykata që të ë njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj konform ligjit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese ashtu që me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari i parë në fjalën përfundimtare deklaroi se, siç deklarova më parë e ndiej veten fajtor për veprën penale që më ngarkon akuza, rasti që na ka ndodh ka qenë krejt i atëçastshëm, me të dëmtuarin nuk jemi njohur asnjëherë më parë dhe vlen të ceket se me të njëjtin pas ndodhjes së rastit jemi marr vesh për këtë mosmarrëveshje dhe kemi pasur që këtë çështje të zgjidhim në procedurën e ndërmjetësimit por i njëjti siç kemi mësuar ka dal jashtë shtetit dhe sa di unë më nuk është kthyer në Kosovë dhe për këtë kemi mbetur që këtë marrëveshje të mos e konkretizojmë pran organeve të drejtësisë, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se edhe në të ardhmen nuk do përsëri kësi vepre penale apo të ngjashme pasi nuk jam njeri i problemeve por merrem me punët e mia.

I akuzuari i dytë në fjalën përfundimtare deklaroi se, edhe unë siç deklaroi edhe i akuzuari i parë jam i penduar për rastin që na ka ndodh i cili na ka ndodh rastësisht pasi me të dëmtuarin nuk jemi njohur më parë dhe pas rastit siç deklaroi edhe i akuzuari i parë ne jemi marr vesh me

të dëmtuarin dhe kemi pasur që këtë mosmarrëveshje ta zgjidhim me ndërmjetësim por ai ka udhëtuar jashtë shtetit, është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin dhe premtoj se në të ardhmen nuk do të përsëris këso vepra penale apo të ngjashme pasi tani veç jam martuar dhe jetoj jashtë shtetit.

### **Të gjeturat e gjykatës - matja dhe shqiptimi i dënimit.**

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive për shkak të bashkëkryerjes së veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe të akuzuarit u shpallën fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese në shqyrtimin gjyqësorë se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë, kanë shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të përsërisin këso lloj vepra penale, se për herë të parë kanë ra ndesh me ligjin, ndërsa në rastin konkret si rrethana renduese nuk gjeti dhe përveç kësaj vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave të lartcekura gjykata të akuzuarve u shqiptoi dënim me gjobë me bindje se edhe me të do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi me gjobë është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike, është marruar në kuptim të nenit 462 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë dhe të procedurës, është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë konform nenit 36 par 3 pika 3.1, Nr. 08/L-109 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të theksuarave më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**  
**2020:004336, e datës 25.11.2024**

**Zyrtare ligjore**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

**Kimete Bytyqi**

**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30 ) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.